

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E RENDIT PUBLIK    PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

---

*Nr 273 Prot. dt 28. 1.2004*

*Nr. 256 Prot. 28. 1.2004*

**URDHËR I PËRBASHKËT  
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FORCËS SË POSAÇME  
KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR**

***Mbështetur në:***

- Nenin 102, paragrafin 4 të Kushtetutës;
- Ligjin Nr. 8737, dt 12.02.2001 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë*"
- Nenin 8, paragrafin .4 të Ligjit Nr. 8677, dt. 02.11.2002 "*Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjqësore*"

Si dhe në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrit të Shtetit, Ministrit të Rendit Publik dhe Prokurorit të Përgjithshëm,

**URDHËROJMË:**

1. Krijimin e Forcës së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar, në rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier dhe Vlorë.
2. Në rrethin e Tiranës, zyra e Forcës së Posaçme përbëhet si më poshtë:
  - a) Të paktën katër prokurorë, njëri prej të cilëve do të caktohet drejtues i Forcës së Posaçme të Krimit të Organizuar për rrethin e Tiranës;
  - b) Dyfishin e këtij numri me punonjës të policisë të roleve të mesëm e të lartë, të cilët do të merren nga efektivi i policisë gjyqësore

pranë një' prokurorie, nga sektori i Hetimeve të Posaçme në Nëndrejtorin Kundër Krimit të Organizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Nëndrejtoria Kundër Krimit të Organizuar dhe/ose nga Drejtoria e Policisë Kriminale.

3. Në rrethin e Durrësit, zyra e Forcës së Posaçme përbëhet si më poshtë:
  - a) Të paktën tre prokurorë, njëri prej të cilëve do të caktohet drejtues i Forcës së Posaçme për rrethin e Durrësit;
  - b) Dyfishin e këtij numri me punonjës të policisë të roleve të mesëm dhe të lartë, të cilët do të merren nga efektivi i policisë gjyqësore pranë një prokurorie, nga Nëndrejtoria Kundër Krimit të Organizuar dhe/ose nga Drejtoria e Policisë Kriminale.
  
4. Në rrethet Shkodër, Fier dhe Vlorë, Forca e Posaçme përbëhet si më poshtë:
  - a) Të paktën dy prokurorë për secilin rreth, njëri prej të cilëve do të caktohet drejtues i zyrës përkatëse të Forcës së Posaçme;
  - b) Dyfishin e këtij numri me punonjës të policisë të roleve të mesëm dhe të lartë të cilët do të merren nga efektivi i policisë gjyqësore pranë një prokurorie, nga Nëndrejtoria Kundër Krimit të Organizuar dhe/ose nga Drejtoria e Policisë Kriminale.
  
5. Prokurorët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, të emëruar pranë Forcës së Posaçme të Krimit të Organizuar qëndrojnë në këtë detyrë për një periudhë jo më pak se 5 vjet, me përjashtim të rasteve kur ngrihen në detyrë apo nuk arrijnë t'i përmbushin në mënyrë të kënaqshme detyrat e tyre.
  
6. Prokurorët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit në përbërje të Forcës së Posaçme, kanë vartësi të drejtpërdrejtë nga Prokurori i Përgjithshëm ose personi i caktuar prej Tij në Prokurorinë e Përgjithshme.
  
7. Punonjësit e Policisë së Shtetit të të gjitha strukturave qendrore e vendore janë të detyruara të venë në dispozicion të Forcës së Posaçme çdo informacion që disponojnë për veprat penale që ndjek Forca e Posaçme.
  
8. Punonjësit e Policisë së Shtetit që nuk janë anëtarë të Forcës së Posaçme të Krimit të Organizuar vihen në dispozicion të Forcës së Posaçme për kryerjen e veprimeve hetimore e gjurmuese, duke e mbështetur atë dhe me mjete logjistike, në çdo rast që kërkohet prej saj.

9. Shefi i Policisë Kriminale të Qarkut, ku është ngritur e funksionon Forca e Posaçme, me kërkesë të prokurorëve të këtyre njësive, është i detyruar të mbështesë punonjësit e këtyre njësive me informacione, mjete logjistike dhe personel të mjaftueshëm në funksion të realizimit të detyrave.

10. Prokurori i Përgjithshëm dhe personi i caktuar prej tij drejtojnë, kontrollojnë dhe koordinojnë veprimtarinë hetimore të Forcës së Posaçme në të gjithë vendin dhe për të gjitha nivelet.

11. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe personi i përcaktuar prej tij ndihmojnë, mbikëqyrin, koordinojnë dhe mbështetin veprimtarinë e punonjësve të policisë, anëtarë të Forcës së Posaçme.

12. Drejtuesi i çdo zyre të Forcës së Posaçme ka autoritetin të nënshkruajë aktet e kësaj zyre dhe ka autoritetin të përdorë vulën dhe të ushtrojë funksionet e një' prokurori të Shkallës së Parë.

13. Forca e Posaçme ka autoritetin të hetojë cilëndo prej veprave penale të mëposhtme, të caktuara nga Prokurori i Përgjithshëm dhe/ose personi i caktuar prej tij, sipas gjykimit të tyre:

- a) Veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale;
- b) Veprat penale që lidhen me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit;
- c) Veprat penale që lidhen me narkotikët;
- d) Veprat penale në fushën e trafikeve të paligjshme;
- e) Veprat penale ekonomike;
- f) Krimet e dhunshme që lidhen me veprat penale të renditura më sipër;
- g) Vepra të tjera penale që do të gjykohen nga Prokurori i Përgjithshëm ose personi i përcaktuar prej etj.

14. Shefi i policisë kriminale të qarkut, ku vepron Forca e Posaçme është i detyruar të njoftojë drejtuesin e Forcës së Posaçme të Krimin të Organizuar të rrethit për çdo vepër penale që përshkruhet në paragrafin 13 a-g më sipër, kur kjo ndodh brenda juridiksionit që ai mbulon.

15. Për funksionimin dhe rregullimin e brendshëm të veprimtarisë së njësive të Forcës së Posaçme, të parashikuara në këtë Urdhër të Përbashkët, zbatohen parimet dhe rregullat e vendosura në Kodin e Procedurës Penale dhe në aktet e tjera normative të nxjerra nga të dy institucionet

16. Nëse një pjesëtar i Forcës së Posaçme shkel kodin etik të sjelljes ose i nënshtrohet një mase disiplinore, Prokurori i Përgjithshëm ose personi i përcaktuar prej tij do të njoftohen në mënyrë të menjëhershme. Për më tepër, ky pjesëtar i Forcës së Posaçme do të pezullohet menjëherë prej detyrave dhe përgjegjësive në Forcën e Posaçme. Përveç pezullimit të menjëhershëm nga ushtrimi i funksioneve në Forcën e Posaçme, masat disiplinore deri në largimin nga detyra apo ndjekjen penale të secilit prej anëtarëve të Forcës së Posaçme, do të kryhet sipas akteve ligjore në fuqi. Pezullimi nga detyra i çdo pjesëtari të Forcës së Posaçme bëhet me kërkesë të prokurorit që drejton Forcën e Posaçme të Krimin të Organizuar për rrethin dhe miratim të Drejtorit të Krimin të Organizuar.

17. Me këtë Urdhër të Përbashkët të njihen prokurorët dhe të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit.

18. Me kontrollin dhe zbatimin e këtij Urdhri të Përbashkët ngarkohen Drejtoria e Krimin të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

19. Moszbatimi i këtij Urdhri ngarkon me përgjegjësi disiplinore çdo prokuror ose punonjës policie sipas akteve ligjore në fuqi.

20. Ky Urdhër i Përbashkët hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I RENDIT PUBLIK  
Igli TOSKA



PROKURORI I PËRGJITHSHËM  
Theodor SOLLAKU

